

MESAZHI KRYEBARITOR I FORTLUMTURISË SË TIJ

MITROPOLITI +TIKON

LINDJA E KRISHTIT 2017

KRISHTI U LIND! LAVDËROJENI!

Klerikëve të Nderuar, Monahëve të Vyer dhe Besimtarëve të Devotshëm të Kishës Ortodokse në Amerikë,

Vëllezërit e mi të dashur dhe Fëmijë të Bekuar në Zotin,

Me ardhjen të fundvitit civil, ne reflektojmë përsëri në një periudhë në të cilën tragjeditë, aktet e terrorizmit, të shtënat në hapësirat publike, konfuzioni politik dhe akuzat për sjellje të pahijshme seksuale dominojnë lajmet. Errësira që mbulon botën shton barrën e përpjekjeve tona personale dhe familjare: varësive, izolimit, divorcit dhe çdo lloj konflikti të krijuar nga pasionet njerëzore. Mund të jemi të tunduar të pyesim se si dashuria mund të ketë ikur kështu përfundimisht nga zemrat e qenieve njerëzore.

Festa e Lindjes në Trup e Zotit tonë, Perëndisë dhe Shpëtimtarit Jezu Krisht është një kujtesë për të gjithë ne që “qielli dhe toka sot gëzojnë profetikisht”, engjëjt dhe njerëzit “mbajnë festën shpirtërore për Perëndinë, të lindur nga një grua dhe të shfaqur në trup atyre që rrinin në errësirë dhe në hije”. Drita që marrim sot nuk është thjesht një dritë fizike që përshkon errësirën që na rrethon, por më tepër një dritë transformuese që zbulon dashurinë e Perëndisë për ne dhe na frymëzon të rritemi në dashurinë tonë për Perëndinë.

Nuk ka filozofi apo ideologji që mund të kapërcejnë absurditetin e botës. Është vetëm drita shpërfytyruese e Krishtit, dashuria e Tij hyjnore dhe sakrifikuuese, që mund ta arrijë këtë. Vetëm nëpërmjet dashurisë, me kafshët dhe grazhin, ne mundemi "ta pranojmë Atë, i Cili me anë të Fjalës së Tij na ka zgjidhur ne banorët në tokë nga veprimet që janë kundër arsyes". Kur dëshpërohemi nga tragjeditë në botë dhe në jetën tonë, le të kujtojmë se Fjala e Perëndisë zgjodhi të mishërohet pikërisht në mes të errësirës së tillë.

Arhimandriti Zaharia sugjeron që: "Kur përballemi me rrënojat e dashurisë njerëzore dhe e gjejmë veten tonë të shkatërruar plotësisht, atëherë dy zgjidhje mund të jepen: ose të kthehemi te Perëndia me dhimbjen tonë, kështu që Perëndia të hyjë në jetën tonë dhe të na përtërijë, ose të vazhdojmë të mashtrohemi nga planet tona njerëzore dhe të rrëshqasim nga një tragjedi dhe shterpësi e shpirtit në një tjetër, duke shpresuar që një ditë do të gjejmë përsosmëri".

Bota është e dëshiruar për një dashuri autentike, por duket se mbetet e zhytur në tragjeditë globale që shohim çdo ditë. Në marrëdhëniet tona horizontale dhe njerëzore me njëri-tjetrin, ajo që mungon është Vetë Perëndia, një person i tretë divino-human që pastron dhe shëron marrëdhëniet tona inperfekte dhe të prishura. Qoftë që është burri dhe gruaja, vëllai dhe motra, ose komunitete më të mëdha, dashuria e vërtetë dhe paqja e qëndrueshme mund të gjenden vetëm përmes bashkimit tonë me Perëndinë.

Në kontekstin tonë ortodoks, kjo bëhet nëpërmjet Liturgjisë Hyjnore dhe nëpërmjet përpjekjeve tona për të ushqyer dashurinë sakrifikuese të Perëndisë në zemrat tona. "Parajsa fillon në tokë nëpërmjet dashurisë për Perëndinë dhe dashurisë për miqtë tanë. Në këtë qëndron e gjithë pasuria e jetës së përjetshme, sepse njeriu është krijuar për t'i dhënë lavdi të përjetshme Perëndisë. Kënaqësia e Tij është ta rikthejë këtë lavdi tek imazhi i Tij, njeriu, i cili pastaj i kthen lavdi më të madhe Krijuesit të tij. "

Festa e sotme është një kujtesë se është nëpërmjet këtij cikli të lavdërimit dhe dashurisë mes Perëndisë dhe njeriut, që ne gjejmë përmbushjen tonë të vërtetë. Qoftë që Krishti i sapolindur të na japë kurajo për të mbajtur dashurinë e Tij në zemrat tona, të lidhenmi me miqtë tanë nëpërmjet lutjes, sakrificës dhe përlësisë dhe të kujtojmë se, pavarësisht masës së renies sonë apo të botës, Krishti erdhi të na japë shpresë për ripërtëritje, "për çka Ai ishte, Ai mbeti, Perëndia i vërtetë, dhe atë që Ai nuk ishte, Ai mori mbi Veten e Tij, duke u bërë njeri nëpërmjet dashurisë për njerëzimin".

Me dashuri në Krishtin e sapolindur,



+ Tikoni
Kryepeshkop i Uashingtonit
Mitropolit i Gjithë Amerikës dhe Kanadasë